



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT  
DHE MJEDISIT  
MINISTRI

Nr. 5758/Prot.  
3

Tiranë, më 03.11 2017

## DEKLARATË MJEDISORE

*për Vlerësimin Strategjik Mjedisor*

Në mbështetje të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

### PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË MALËSI E MADHE

Kufijtë e zonës që mbulon plani: sipërfaqja në administrimin e bashkisë Malësi e Madhe, njësitë e saj administrative.

#### Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

#### Qëndrimi i ministrisë:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutese, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vleresimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatës.

#### Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ndryshimet klimatike, si edhe për

popullatën dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë ndikime mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe ndikimet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqëndrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

#### Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave:

Ndërverprimi i PPV-së me mjedisin pritet të shprehet kryesisht në;

- Rritjen e nivelit të inputeve bujqësore (azot, fosfor, pesticide) në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Tjetërsim, reduktim dhe degradim të habitateve natyrore;
- Përshqetësim të gjallesave;
- Shkarkime të mundshme në ajër, në tokë, ujëra sipërfaqësore gjatë ndërtimit dhe operimit;
- Trafik të shtuar në zonën e operimit;
- Shtim të nivelit të zhurmave dhe trafikut hekurudhor.

Disa prej projekteve të planit pritet të prodhojë ndikime pozitive në mjedis, ndërsa të tjera bien në kategorinë pa ndikim, me ndikim të ulët, të mesëm dhe të lartë. Shumica e projekteve të propozuara ka ndikim pozitiv deri të ulët. Për një pakicë të projekteve konsiderohet se mund të ketë ndikim mjedisor të mesëm deri në të lartë. Megjithatë efekti i tyre pritet të jetë më i ulët nëse zbatimi shoqërohet me masa zbutëse.

#### Detajimi i masave për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brënda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia Malësi e Madhe, nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit, të hartojë një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë së Mjedisit jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.
- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efiçente në përdorimin e energjisë, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri, po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Plani duhet të nxitë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujrave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të perfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do zbatohen mund të prekin zona të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Plani të marrë masa për promovimin e transportit publik të pasagjerëve që të kontribuojnë në pakësimin e shkarkimeve në ajër.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brënda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje. Promovimi brënda dhe në periferitë e

zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.

- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelbërta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të kenë objektiva të matshme për cilesinë e ajrit.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmytjeve).
- Të zbatohen kërkesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësise së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.

#### Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarishtë masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- › Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëhere deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- › Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëhere ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit deri në sqarimin e situatës.
- › Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëhere ministria i kërkon autoritetit miratues e propozues të merren masat e duhura apo të konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.

- › Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
BASHKËA NALPISI E MADMIRATIT  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHYLLIMIT

MINISTËR  
  
Blendi KLOSI



№ 2315 / 2017

Likja Dëgjim deklaratorion

MINISTRIE E MADMIRATIT  
TIRANE

Në vijim të rregullave vlerës me №3738/1, datë 08.08.2017, administrativ me serinë me №.3401,  
datë 10.08.2017, në rezultat të ndërkohës i shprehur që e kanë hartuar raportin e Vlerësimit  
Deklarator. Një-lindur të jetë funksionit du të përfaqësojë me detyrë të po e rishikojnë materialin e kësaj lloji.

Duke të funksionuar për tërë kohën

